

URDHËRESA DHE PROKLAMATA TË USHTRISË AUSTRO-HUNGAREZE NDAJ SHQIPTARËVE, GJATË MUAJVE SHKURT - QERSHOR 1916

Synimi i këtij punimi është që të trajtojë urdhëresat dhe thirrjet e ushtrisë austro-hungareze gjatë dhe pas vendosjes së saj në Shqipëri.

Materialet, në të cilat jemi mbështetur, janë proklamata dhe urdhëresa të ushtrisë austro-hungareze të vitit 1916. Si burim kryesor janë marrë dokumente të kohës që janë botuar në Shqipëri gjatë atij viti. Austro-hungarezët u bënë thirrje të gjithë shqiptarëve, të të gjitha përkatësive fetare, që t'i kapin armët për t'i përzënë ushtrinë serbe dhe malazeze nga territoret shqiptare.

Administrata austro-hungareze nxori disa urdhëresa, udhëzime dhe proklamata drejtuar popullsisë shqiptare, si urdhëresa mbi udhëtimet në Shqipëri dhe jashtë saj, urdhëresa për dorëzimin e armëve, faljen e përgjithshme të gjaqeve etj.

Thirrjet dhe proklamatat ndodhen në Bibliotekën Nacionale të Austrisë. Thirrjet, të cilat shtypeshin në shtypshkronjën "Nikaj" në Shkodër dhe në shtypshkronjën "Etappen Stations Komandos" në Durrës, bëheshin në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe gjermane.

Thirrjet e ushtrisë austro-hungareze në fillim të vitit 1916

Lufta e Parë Botërore e kishte gjetur Shqipërinë në një gjendje të rëndë politike, ekonomike dhe sociale, pasi ishte shkatërruar nga zhvillimet e saj dhe nga kryengritja e Shqipërisë së Mesme. Lufta e Madhe, siç njihet ndryshe, kishte ardhur pas rivaliteteve të Fuqive të Mëdha për ndarjen e territoreve, sidomos të kolonive në Afrikë dhe Azi. Në fillim të vitit 1915, Shqipërinë e Veriut dhe të Mesme e kishin pushtuar ushtritë serbe dhe malazeze, në janar

42 Shpend Avdiu-Instituti Albanologjik i Prishtinës

të vitit 1916 në ndjekje të ushtrisë serbe, ushtria austro-hungareze kishte pushtuar Shkodrën, Elbasanin, Durrësin dhe Tiranën.⁴³

Pas largimit të forcave ushtarake të shteteve ballkanike nga territoret e shtetit shqiptar, popullsia shqiptare e kishte mirëpritur ardhjen e ushtrisë austro-hungareze. Edhe politika shqiptare e kohës i përkrahte forcat austro-hungareze, madje këto forca konsideroheshin si çlirimtare, pasi fqinjët ballkanikë kishin pretendime territoriale dhe kishin shkaktuar shumë krime gjatë zhvillimit të Luftës së Parë Ballkanike.⁴⁴ Ushtria serbe i kishte shkaktuar dëme të mëdha popullsisë shqiptare të zonave të Veriut të Shqipërisë, prandaj shqiptarët kishin arsye ta konsideronin si çlirimtare ushtrinë austro-hungareze.

Në historiografinë serbe, shqiptarët konsideroheshin si “kusarë”, “barbarë”, të cilët nuk ishin përkujdesur për ushtrinë serbe. Këtë historiografia serbe e quante si “Golgota serbe”. Kjo historiografi i lë anash vuajtjet dhe krimet, që ishin bërë muaj më parë nga ushtria serbe.⁴⁵

Administrata ushtarake austro-hungareze, edhe pse përkrahej nga disa qarqe politike shqiptare, mendohej që të kufizonte dhe të pengonte çdo veprimtari politike shqiptare. Pas shpalljes së Republikës Autonome të Korçës, më 10 dhjetor 1916 nga ushtria franceze, si kundërpërgjigje, në janar të vitit 1917, komanda e ushtrisë austro-hungareze, me anë të një proklamate, shpalli autonominë e Shqipërisë nën protektoratin austriak.⁴⁶

Gjatë vendosjes së trupave austro-hungareze në Shqipëri zhvillohej propagandë e madhe duke shpërndarë thirrje dhe urdhëresa që shqiptarët të bashkoheshin me trupat austriakë. Në këto thirrje, që fillonin më titullin: “Shqiptarë”!, bëhej thirrje në këtë mënyrë: “Ushtria e Austro-Hungarisë ka kaluar kufijtë e Shqipërisë. Dhe nuk kemi ardhur këtu si armik, si ata pushtuesit e mëhershëm, që kanë shfrytëzuar të mirat e vendit

43 Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar, III - Periudha e Pavarësisë, 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939*, AShSh, Tiranë, 2007, p. 83-84

44 Ibid.

45 Oliver Schmitt, *Kosova, Histori e shkurtër një e treve qendrore ballkanike*, Koha, Prishtinë, 2012, fq. 143

46 Arsh.G. LL, Senkeviçi, I.G, Smirnova. N. D, *Histori e shkurtë e Shqipnisë, Rilindja, Prishtinë, 1967, fq. 191*

tuaj, por kemi ardhur si miq të shqiptarëve". Në këtë thirrje u premttohej shqiptarëve që do t'i largonin mbetjet e ushtrisë serbe në Shqipëri, të cilat kishin humbur nga austro-hungarezët dhe ishin vendosur në Shqipëri. Po ashtu, shqiptarëve u premttohej se austro-hungarezët do ta sulmonin dhe një pakicë të ushtrisë italiane që donte të hynte në Shqipëri.⁴⁷

Gjithashtu, bëhej thirrje që të gjithë, secili shqiptar, çfarëdo religjioni që i takon, musliman apo i krishterë, të kapin armët për t'i përzënë armiqtë me gjithë forcën që kanë.⁴⁸

Në një thirrje tjetër propaganduese drejtuar popullsisë që t'i bashkohej vullnetarisht forcave austro-hungareze, premttohej se do t'i luftonin armiqtë e tyre tradicionalë, Serbinë e Malin e Zi, si dhe do të organizohej mësimi i shkrimit dhe leximit shqip, ushqim i mirë, rrogë si dhe trajtim njësoj sikurse vetë ushtarët austro-hungarezë. Në thirrje thuhej që secili që dëshiron që t'u bashkohet forcave austro-hungareze, informacionet do t'i merrte nga priftërinjtë dhe hoxhallarët. Në këtë thirrje thureshin elozhe dhe lëvdata për trimërinë e popullit shqiptar, edhe për kohën e lavdishme të Skënderbeut.⁴⁹

Kjo thirrje e ushtrisë austro-hungareze ishte shpërndarë në Shkodër dhe në Durrës. Një thirrje e ngjashme ishte bërë në atë kohë edhe nga Prek Bib Doda, Seid Pasha, Akif Pasha, Feizi Beu dhe Luigj Gurakuqi, që t'i bashkohen ushtrisë austro-hungareze.⁵⁰

47 Kjo proklamata gjendet në Bibliotekën Nacionale të Austrisë në Vjenë me titullin: (më tej ÖNB) Titel:Albaner! - Österreichisch-ungarische Truppen in Albanien - Skutari – Mehrsprachiges PlakatOrt/Verlag: Skutari;

48 ÖNB; Titel:Albaner - Kundmachung - Mehrsprachiges Plakat; Ort/Verlag: Durz Datierung: vermutlich 1916; Schlag Wörter: Albanien; Durazzo; Durres; Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914-1918; Kriegssammlung; Textplakat; Beschreibung: Die österr.-ungar. Truppen haben die Grenzen Albaniens überschritten.

49 ÖNB; Titel: Shqypetaren! - Militärische Erziehung - Skutari - Mehrsprachiges Plakat; Datierung:1916-04-29; SchlagWörter: Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914-1918; Franz Joseph I., Kaiser von Österreich; Kriegssammlung; Militär; Shkoder; Textplakat; Trollmann von Lovcenberg, Ignaz Freiherr; Verwaltung; Beschreibung: Befreiung durch Truppen des Kaisers vor den Feinden

50 ÖNB;Titel: E çmëshmja besniki vellasenore Shqypetare - In albanischer Sprache; Datierung: um 1916; Schlag Wörter: Durazzo; Durres; Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914-1918; Kriegssammlung;

Për të marrë përkrahje sa më të gjerë të popullsisë shqiptare, Perandori i Austro-Hungarisë, Franz Josefi I, i ishte drejtuar popullit shqiptar me një letër falënderimi për përkrahjen e forcave austro-hungareze nga shqiptarët, si dhe për dhënien e fjalës për besnikëri, e cila në fakt shërbente për propagandën e ushtrisë austro-hungareze që populli shqiptar të bashkohej me ta. Po ashtu, bënte thirrje që kjo shkresë të përhapej në çdo vend. Ky dokument ishte lëshuar në Durrës nga koloneli Berst von Farkas.⁵¹

Më datën 1 shkurt të vitit 1916, komandanti i ushtrisë austro-hungareze në Shkodër, Rudolf Maricic, u bënte thirrje shqiptarëve patriotë të Shkodrës që t'i bashkoheshin në luftë për ta çliruar vendin nga forcat serbe, duke i ftuar që të mblidhen në "Milet-Bahçe" ata që dëshirojnë që t'u bashkohen forcave austro-hungareze si dhe që të mësonin rregullat që do të zbatonin në ushtrinë austro-hungareze.⁵²

Më 3 shkurt të vitit 1916 ishte lëshuar edhe një proklamata tjetër, që u bënte thirrje vullnetarëve të Shkodrës, të cilët i kishin bashkuar ushtrisë austro-hungareze, që besa e dhënë kundër hakmarrjes së gjaqeve të respektohet, në të kundërtën shkelësit do të dënoheshin me vdekje dhe thuhej që vetëm ushtria austro-hungareze do të ketë të drejtë për çfarëdo pune gjykimi dhe drejtësie.⁵³

51 ÖNB; Titel: Franz Josef - Bessa - Verlautbarung - Kundmachung - Durz - Mehrsprachiges Plakat; Ort Verlag: Durz; Datierung: vermutlich 1916; Schlag Wörter: Durazzo; Durres; Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914 - 1918; Franz Joseph I., Kaiser von Österreich; Kriegssammlung;

52 ÖNB, Titel: Bekanntmachung - Shkodra - In albanischer Sprache, Datierung: 1916.02.01, Schlag Wörter: Bekanntmachung; Ersterwelkrieg; Kriegssammlung; Shkoder; Textplakat, Beschreibung: Bekanntmachung des Kommandanten k. u. k. Kapitän Rudolf Marcic - Shkodra, 1. Ferbuar 1916, Digitale Sammlung: Kriegssammlung, Maße: Maße des Objekts 37cm x 26cm (Höhe xBreite), Standort: ÖNB Bildarchiv und Grafiksammlung (POR), Signaturen: KS 16214270.

53 ÖNB;Titel: Bekanntmachung-Shkodra- In albanischer Sprache; Datierung:1916-02-03; Schlag Wörter: Bekanntmachung; Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914 - 1918; Kriegssammlung; Shkoder.

Urdhëresa mbi udhëtimet në Shqipëri dhe jashtë saj

Më 6 mars të vitit 1916, në Shkodër ishte paraqitur një urdhëresë për udhëtime brenda dhe jashtë Shqipërisë, e cila ishte një udhërrëfyes se si do të udhëtonin qytetarët shqiptarë në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe udhëzonte qytetarët shqiptarë, të gjithë ata që kanë hotele, hane dhe atyre që flenë në to, po ashtu dhe qytetarë të huaj të lajmëronin policinë brenda 5 orëve.⁵⁴ Në këtë urdhëresë ngarkoheshin qytetarët që mbanin në shtëpi private qytetarë të huaj, të lajmëronin në xhandarmërinë më të afërt. Në lejen e udhëtimit (pasaportë) kërkohej që të detajohej qëllimi i udhëtimit brenda dhe jashtë vendit. Leje udhëtimit për qytetarët shqiptarë kërkohej dhe për kalimin nga një krahinë në tjetrën. Me këtë dokument, që merrej në zyrat e xhandarmërisë në qendrat më të mëdha administrative të Shqipërisë që ishin të pushtuara nga forcat austro-hungareze, mund të udhëtohej vetëm për një periudhë dyjavore brenda vendit. Po ashtu, kërkohej që edhe për udhëtimin nga një lagje në lagjen tjetër të merrej një leje në xhandarmerinë më të afërt.⁵⁵

Një urdhëresë e tillë, lëshuar përsëri tre muaj më vonë, e përmirësuar dhe e riformuluar, e cila vllente për të gjitha pjesët e pushtuara të Shqipërisë nga forcat austro-hungareze, shfuqizonte urdhëresën e mëhershme dhe sillte disa rregulla të reja. Këto dy urdhëresa parashihnin rregullat e udhëtimit të të gjithë qytetarëve, të secilës shtresë. Urdhëresa për udhëtime brenda Shqipërisë, e qershorit të vitit 1916, parashihte që për udhëtimin nga një krahinë në një tjetër duhej të merrej një leje (dëftesë) nga xhandarmeria lokale, në vendin ku shkon.

Ndërsa për të udhëtuar jashtë vendit duhej të merrej një leje speciale dhe të bëhej një ekzaminim mjekësor për secilin udhëtar që udhëtonte në Mal të Zi, Serbi, Austro-Hungari, Bullgari dhe Turqi. Mbi pasaportë do të shkruhej që nuk kishte asnjë sëmundje

54 ÖNB Titel: Reisebestimmungen - Bekanntmachung - Shkodra - In albanischer Sprache; Ort Verlag: Shkodra. Datierung: 1916-03-06; Schlag wörter: Bekanntmachung; Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914 - 1918; Kriegssammlung; Polizei; Reisen; Shkoder; Textplakat; Beschreibung: "Zyrja P. e M. c Pasaportavet n' Shkoder, P. P. N. 16." - Polizeiliche Vorschriften bezgl. des Reisens - Sertic m. p. Oberstleutnant - Shkoder, me 6 Marc 1916; Legende: Shtypshkroja "Nikaj" Shkoder.

55 Ibid.

si dhe bëhej një përshkrim se nga mund të kalohet prej një vend në një vend tjetër.

Edhe në urdhëresën e dytë, udhëtarët e huaj që do ta vizitonin Shqipërinë, ishin të detyruar të paraqiten në zyrat e xhandarmërisë për hyrjen dhe vendosjen e tyre në Shqipëri. Ndërsa të gjithë ata që mbanin hotele dhe hane, ishin të detyruar që për secilin mysafir t'i raportonin xhandarmërisë brenda 12 orëve. Për ata që nuk u përmbaheshin këtyre rregullave, parashiheshin dënime me të holla, edhe paraburgim deri dy javë. Ky dokument ishte lëshuar nga komandanti i forcave austro-hungareze, Ignaz Trollmann.⁵⁶

Këto urdhëresa për udhëtimin e qytetarëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit shërbenin për mbajtjen në kontroll të sigurisë në territoret shqiptare që i takonin zonës austro-hungareze, për rreziqet e mundshme që vinin nga jashtë, kur dihet që Shqipëria ishte e ndarë në tri zona pushtuese: italiane, franceze dhe austro-hungareze. Po ashtu, këto urdhëresa për udhëtim shërbenin dhe për evitimin e sëmundjes së kolerës, e cila ishte përhapur në atë kohë në Shqipëri.

Urdhëresa mbi faljen e gjaqeve dhe dorëzimin e armëve

Komanda e ushtrisë austro-hungareze kishte lëshuar dhe një urdhëresë, më 29 prill 1916, për ndaljen e gjakmarrjes, për një besë të përgjithshme për gjashtë muaj. Për ata që do të merrnin gjakun ose do të kryenin ndonjë vrasje të re, parashihej dënim me varje.

Dënime parashiheshin edhe për ata që do t'i strehonin apo do t'u ndihmonin gjakmarrësve. Në këtë urdhëresë parashihej

56 ÖNB;Titel: Reisevorschriften - Kundmachung - Skutari - Mehrsprachiges Plakat; Ort Verlag:Skutari; Datierung: 1916-06; Schlag Wörter:Erster weltkrieg; Europeana Collections 1914 - 1918; Kriegssammlung; Meldepflicht; Reise; Shkoder; Textplakat; Trollmann von Lovcenberg, Ignaz Freiherr; Verwaltung; Beschreibung: Reisen im Inland, innerhalb eines Bezirkes, in einen anderen Bezirk - Reisen in die Monarchie, Montenegro und Serbien sowie nach Deutschland, Bulgarien und die Türkei - Übergangspunkte für Grenzüberschreitungen nach und von Albanien - Meldepflicht der Reisenden - Übertretungen und Strafen - Schkodra, im Juni 1916 - Trollmann - K.u.K. Höchstes Kommando in Albanien - K.Nr. 758 1916; Digitale Sammlung; Kriegssammlung; Maße: Maße des Objekts 39cm x 57cm (Höhe x Breite); Standort: ÖNB Bildarchiv und Grafiksammlung (POR); Signaturen:KS 16214279 ; 1914-1918/IV.

që pas një kohe të bëheshin dhe falje të përgjithshme të gjaqeve.⁵⁷ Po ashtu, tri ditë më vonë, nga gjenerali Ignaz Trollmann ishte lëshuar një urdhëresë për dorëzimin e armëve, si dhe dhënien e lejeve të tyre.

Premtohej se në secilën armë që do të dorëzohej, do të vendosej emri dhe numri i pronarit si dhe poseduesit do t'i jepej një dëshmi e dorëzimit të armës. Armët që nuk do të dorëzoheshin, ishin ato të vjetra të cilat mbusheshin për gryke, armët e plakut të fisit e të bajrakut nuk dorëzoheshin, sikurse edhe armët të cilat u liheshin për nderë etj.

Ky urdhër caktonte vendet ku do të dorëzoheshin armët: Shkodër, Përkal, Abat, Bunjaj, Pukë, Orosh, Lumë, Lezhë, Burgajet, Peshkopi, Durrës, Tiranë, Elbasan dhe Kavajë.⁵⁸ Në këtë urdhëresë parashiheshin shpërblime për secilin katund apo fis që do të dorëzonte armët pa ndonjë problem. Shpërblimi parashihej të jepej në para ose në bagëti. Nga këto dokumente shihet që ushtarakët Austro-Hungarez, njihnin mirë mentalitetin shqiptar dhe botën e tyre. Po ashtu parashiheshin dënime dhe ndëshkime për ata që nuk do t'i dorëzonin armët me kohë.⁵⁹ Një urdhëresë mjaft interesante ishte lëshuar në Durrës, më 17 qershor të vitit 1916, me të cilën urdhëroheshin të gjithë qytetarët e Durrësit që, për shkak të përhapjes së sëmundjes së kolerës, ishte ndaluar të shiteshin pemë dhe perime për ushtarët austro-hungarezë dhe u bëhej thirrje qytetarëve se për çfarëdo sëmundje të lajmëronin doktorin e ushtrisë.⁶⁰

57 ÖNB; Titel: Shqypetaren! - Ausrufung des Landfriedens(Bessa)- Skutari - Mehrsprachiges Plakat; Ort/Verlag:Skutari; Datierung: 1916-04-29; Schlag Wörter:Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914- 1918; Frieden; Kriegssammlung; Shkoder;

58 ÖNB; Titel:Bestimmungen für die Abgabe der waffen - Skutari- Mehrsprachiges Plakat; Ort Verlag: Skutari; Datierung:1916-05-01;Schlag Wörter:Ablieferung; Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914 1918; Kriegssammlung; Shkoder; Textplakat; Trollmann von Lovcenberg, Ignaz Freiherr; Waffe;Beschreibung: Aufgrund des Landfriedens (Bessa) Abgabe der waffen

59 Ibid.

60 ÖNB; Titel: Cholerafälle - Kundmachung - Durz - In albanischer Sprache; Ort Verlag:Durz ; Datierung:1916-06-17; SchlagWörter:Cholera; Durazzo; Durres; Erster Weltkrieg; Europeana Collections 1914 - 1918; Gemüse; Infektionskrankheit; Kriegssammlung; Textplakat;